



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 38
Prishtinë, më 30.01.2019, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Elmi Reçica, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Evgjëni Thaçi-Drăgusha dhe Zafir Berisha.

Munguan: Fitore Pacolli e Sërgjan Mitroviq.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerta Bejtullahu-EUSR/EU Office; Naim Jakaj, Blerim Sallahu,-Kuvendi i Kosovës dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.

Vjosa Osmani -Sadriu theksoi se vendimi i komisionit ka qenë që kjo mbledhje të mbahet më 4 shkurt, përkundër faktit se ne, si opozitë, ishim të gatshëm që atë ta mbajmë në mbledhjen e kaluar. Ajo tha se kërkesa për ta mbajtur mbledhjen më herët, nuk i është afruar.

Elmi Reçica tha se në mbledhjen e kaluar ka kërkuar që mbledhja e komisionit për shqyrtimin e projektligjit të mbahet gjatë pauzës së seancave.

Dukagjin Gorani lidhur me projektligjin tha se janë të interesuar që ky projektligj të procedohet sa më shpejt. Meqë kryetarja e komisionit në mbledhjen e kaluar tha se projektligji ende nuk i ka përmbushur afatet ligjore që atë ditë të shqyrtohet në komision, i bje që sot i përmbush kushtet

që të shqyrtohet. Sa i përket përmbajtjes së projektligjit tha se me përmbajtjen e tij janë të njoftuar të gjithë deputetë dhe se është në interes që të kalon sa më shpejt dhe të debatohet e shqyrtohet në seancë.

Vjosa Osmani- Sadriu tha se ky projektligj nuk e bën pozicionimin ndaj negociatave të deritanishme dhe nuk tregon cili do të jetë qëndrimi lidhur me tërë atë që është negociuar deri tani, e po ashtu as sa i përket integritetit territorial. Sa i përket temave tha se nuk ka kufizim, nuk saktësohen përgjegjësitë dhe kompetencat, se çka ka të drejtë ky delegacion të dialogojë e çka jo. Rezoluta e Kuvendit që ka karakter politik e përmend pacenueshmërinë dhe pa tjetërsueshmërinë e integritetit territorial. Ky projektligj në mënyrë indirekte legalizon jo vetëm rolin e Presidentit, por edhe negociatat që ai i ka mbajtur deri tani për territorin e vendit duke e quajtur institucion kushtetues i ftuar. Përderisa qëndrimi i gjithë opozitës deri tani ka qenë që të mos pranohet roli i presidentit në këtë dialog, ky ligj vetëm e konfirmon rolin e tij, e as nuk i kundërshton asnjë nga temat që ai i ka hapur. Ky ligj konstaton se është lex specialis, që i jepet superioritet mbi çdo ligj tjetër të miratuar nga Republika e Kosovës. Sa i përket komisionit ad hoc që propozohet në projektligj, është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit dhe që i bije, që delegacioni ta mbikëqyrë vetveten e që po ashtu është në kundërshtim me Rezolutën. Zonja Osmani tha se tek emërimet zakonisht është parim që me të njëjtën metodë që emërohet një trup po ashtu edhe shkarkohet, përderisa këtu emërimi bëhet me një shumicë të thjeshtë, ndërsa shkarkimi me 61 vota për, që do të thotë se ky delegacion nuk mund të shkarkohet asnjëherë dhe nuk ka asnjë periudhë kohore që e mbulon mandatin e tij.

Doruntina Maloku -Kastrati tha se është për keqardhje që ne sot në Komision po e trajtojmë një projektligj antikushtetues, sepse Kushtetuta nuk e parasheh miratimin e ligjit lex specialis, i cili do të ketë epërsi edhe ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare. Ajo theksoi se neni 4 i këtij projektligji është në kundërshtim me nenin 11.2, që i bie që delegacioni shtetëror nuk është organi i vetëm për ta drejtuar delegacionin në këtë dialog. Neni 5.1 ku thuhet se delegacioni përbëhet nga 11 anëtarë e në kllapa (12) tha se mendon se i pari është presidenti, e pastaj 11 anëtarët të tjerë, e po ashtu se diferenca në delegacion pozitë-opozitë nuk mund të jetë më shumë se 2 anëtarë. Momentalisht tha se i kemi 8 anëtarë të koalicionit zyrtarisht edhe 3 anëtarë jo zyrtarisht të opozitës, që i bije që 11 anëtarë janë të pushtetit, e që është një disproporcion absolut. Më tej tha se, në nenin 5.4 pjesë e delegacionit shtetëror do të jetë edhe një përfaqësues nga shoqëria civile, të cilin sipas nenit 6.1 e propozon dhe e emëron me konsensus delegacioni. Ajo shtroi pyetjen se kush janë përfaqësuesit e shoqërisë civile, kush i dërgon përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe se delegacioni shtetëror, a është shoqëri civile. Në nenin 8 te komisioni ad hoc i delegacionit, thuhet se komisioni do të ketë edhe anëtarë vëzhgues nga shoqëria civile, ndërsa Kushtetuta e Rregullorja e Kuvendit nuk parasheh të ketë asnjë anëtarë vëzhgues në komisionet parlamentare të Kuvendit. Duke cituar nenin 10 paragrafi. 4.7, pyeti se a do të kthehet në pikën 0 gjithë procesi i negociatave në mes të presidentit Thaçi dhe Vuçiq. Po ashtu te neni 15, lidhur me ruajtjen e sekretit zyrtar, pyeti se si do ta mbikëqyrë Kuvendi i Kosovës procesin dhe dokumentet e delegacionit, nëse të dhënat deponohen si sekret zyrtar.

Elmi Reçica theksoi se projektligji do të trajtohet hollësisht në seancë plenare, dhe se bisedimet e presionet për të vazhduar dialogun me Serbinë janë jashtëzakonisht të rënda dhe kërkuese, siç është edhe tema e cila do të diskutohet.

Theksoi se në mandatin e kaluar nuk kanë biseduar presidentët, por kryeministrat, ku kryeministri Mustafa ka nënshkruar një marrëveshje dhe këto janë pjesë e angazhimeve e përgjegjësisve tona. Kërkoj që të mos zvarritet procesi i shqyrtimi i këtij projektligji dhe i njëjti të përcillet për shqyrtim në parim në seancë plenare.

Doruntina Maloku Kastrati theksoi se dialogu i zhvilluar gjatë mandatit të kryeministrit Mustafa, ka qenë dialog teknik.

Glauk Konjufca theksoi se procesi i dialogut me Serbinë ka shkuar aq larg sa që në një konferencë për shtyp Presidenti Thaçi ka thënë se do të diskutohen 430 km² të kufirit në mes të Kosovës e Serbisë. Kjo tha se është shqetësuese pasi presidenti për një kufi 370 km², thotë se duhet diskutuar për 430 km². Lidhur me idenë e Presidentit të flet edhe për 60 km², mendon se ekziston një projekt për të cilin presidenti ka biseduar me Vuçiqin. Presidenti nuk e ka kompetencën për këtë punë dhe e ka shkelur Kushtetutën, tha z. Konjufca ndërsa ne këtu po merremi me gjëra të kota. Ky dokument që na është përcjellë është thirrje e ndërgjegjes së sponsorizuesve dhe se për këtë projektligj do të drejtohem në Gjykatën Kushtetuese. Kosova tha se e ka një ligj për marrëveshje ndërkombëtare, i cili e ka burimin në nenin 18 të Kushtetutës, ndërsa tani është proceduar ky projektligj i cili thuhet se është më i rëndësishëm se ligji për marrëveshjet ndërkombëtare, gjë që është e rrezikshme, shtoi. Ai tha se zonja Mogeherini ka bërë të ditur se kanë arritur shumë larg pajtueshmëri për arritjen e marrëveshjes, ndërsa në anën tjetër delegacionit nuk po i jepet dokumentacioni.

Zafir Berisha tha se për një çështje kardinale për vendin dhe ligjin, përpjekjet e fundit të institucioneve i shoh si përpjekje për të krijuar një unitet politik edhe qytetar në raport me Serbinë. Uniteti është treguar edhe më parë në dy momente të rëndësishme për vendin, gjatë luftës në Rambuje dhe në rrethanat e reja politike të krijuara pas luftës në vitin 2005. Tha se projektligjit mund të ketë defekte, por mund të jepen sugjerimet lidhur me të në seancë plenare. Ne edhe si subjekte politike dhe si qytetarë tha se duhet t'i shërbejmë një kauze, për përpjekjet që kanë synim të mirën e vendit, e po ashtu në paralel me vërejtjet që i kemi duhet dhënë edhe alternativë.

Time Kadrijaj lidhur me thirrjen e kësaj mbledhjeje tha se nuk ka dashur ta anashkalojë kryetaren e komisionit, por duke pasur parasysh se do të ketë seancë, bazuar në praktikat parlamentare e ka ftuar këtë mbledhje dhe e ka pritur kryetaren që ajo ta kryesojë. Ajo tha se është momenti i fundit që të jemi bashkë për ta dhënë një mesazh të mirë dhe për ta tejkaluar veten. Projektligji tha se pas shqyrtimit duhet të miratohet në parim, e më pas nëse ka vërejtje mund të plotësohet e ndryshohet gjatë leximit të dytë.

Vjosa Osmani- Sadriu duke u ndërlidhur me parafolësit tha se ka pasur momente për t'u bërë bashkë, përfshirë rezolutën e sponsorizuar nga opozita ku kërkohej të përjashtohet mundësia e negociimit të territorit dhe sikur atëherë të kishim përkrahjen, sot nuk do të kishte kundërshti të tilla në këtë ligj dhe do të flisnim me një zë, në mbrojtje të betimeve që kemi dhënë.

Elmi Reçica tha se ne e kemi mbështetur një rezolutë e cila i ka pasur 6 pika, e një ndër ato ka qenë edhe mbrojtja e tërësisë territoriale të Kosovës.

Vjosa Osmani -Sadriu theksoi se nga ato 6 pika të asaj rezolute, nuk është pranuar të hiqet pika 1, e cila ka legalizuar rolin e Presidentit, prandaj kjo ka qenë arsyeja pse ka dështuar kjo rezolutë.

Dukagjin Gorani tha se ky projektligj është rezultat i një përpjekjeje të gjatë nga PSD- ja, e cila angazhohet në këtë proces, që konsiderohet edhe i pashmangshëm edhe i domosdoshëm. Kemi bërë përpjekje të gjejmë një formulim, një konstruksion ligjor i cili i adreson pikërisht vërejtjet e brengat të cilat tani u diskutuan. Ky ligj tha se ka synim transparencën llogaridhënien dhe angazhimin e Kuvendit në procesin e dialogut, e po ashtu ka statusin e lex specialis, por nuk është mbi Kushtetutën.

Vjosa Osmani -Sadriu tha se përderisa flitet për transparencë, sipas projektligjit takimet e delegacionit do të jenë sekrete zyrtare. Ky ligj nuk është mbi Kushtetutën, por tenton t'i delegojë dispozitat e ligjeve të tjera, përfshirë edhe ato të Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare.

Pas diskutimeve lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë

P e r f u n d i m

I rekomandohet Kuvendit që Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, të miratohet në parim.

(Komisioni vendosi me gjashtë vota “për” dhe tri vota “kundër” të deputetëve: Vjosa Osmani Sadriu, Doruntinë Maloku- Kastrati dhe Glauk Konjufca).

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.